



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

**Numri i lëndës:** 2019:258783

**Datë:** 19.01.2021

**Numri i dokumentit:** 01419551

**A.nr.1019/18**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Luljeta Maxhuni, dhe zyrtaren Ligjore Besë Sylaj, në konfliktin administrativ sipas padisë të paditësit F.R., nga komuna e Gj., në adresën Rr. ... nr. ..., kundër të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Administratës Pensionale të Republikës së Kosovës në Prishtinë, për shkak të “anulimit të vendimit”, në shqyrtimin kryesor publik, të mbajtur në mungesë të palëve ndërgjyqëse , me datë 12.01.2021 merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. Aprovohet si e bazuar** kërkesëpadia e paditësit F.R. nga komuna e Gj..

**II. Anulohet** vendimi i datës 23.03.2018, i të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Administratës Pensionale të Republikës së Kosovës në Prishtinë, dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura.

**A r s y e t i m**

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike është mbajtur në kuptim të nenit 41 të LKA-së, në mungesë të palëve ndërgjyqës të ftuar në mënyrë të rregullt gjyqësore (Provë: flet-kthesat e datë 21.12.2020).

Paditësi me datën 04.05.2018, në gjykatë ka parashtruar padi, me të cilën ka kërkuar që kërkesëpadia e tij të aprovohet si e bazuar, të anulohet vendimi i datës 23.03.2018, i të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Departamenti i Pensioneve si i paligjshëm. Më tutje, paditësi në padi ka theksuar se me marrjen e këtij vendimin nuk janë aplikuar drejtë dispozitat e Ligjit Nr.05/L-067 për Statusin e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik.

E paditura në përgjigjen në padi të parashtruar në gjykatë me datën 14.09.2019 e konteston në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar duke theksuar se e paditura pas shqyrtimit të kërkesës së paditësit dhe shkresave të lëndës është vërtetuar se kërkesa e tani paditësit nuk është në harmoni me nenin 8 par.1 të Ligjit Nr.05/L-067, andaj e paditura duke vepruar sipas kërkesës së paditësit mori vendim

me të cilin e refuzojë kërkesën e paditësit për njohjen e kësaj të drejte. Mbi këtë bazë e paditura ka kërkuar nga gjykata që të marrë aktgjykim me të cilin do ta refuzojë si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ta lejë në fuqi vendimin me datës 23.03.2018.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 12.01.2021, ka administruar provat relevante: kopja e letërnjoftimit e lëshuar me dt. 08.05.2014; vendimi i dt. 23.03.2018; kontrate për njohjen e kujdestarit për persona paraplegjik dhe tetraplegjik e lidhur me dt. 16.10.2017, e noterizuar me nr. 7175/2017; vendimi i lëshuar nga MPMS- Departamenti i pensioneve i dt. 02.02.2018; flete lëshimi me nr. amze 201, nga data 13.02.2017-09.03.2017; raport nga konsulta i dt. 12.02.2018; udhëzimi për konsultim i dt. 12.02.2018; dokumenti i lëshuar nga ordianca specialistike Psikiatrike psikiatër për te rritur, fëmijë, adoleshent te dt. 01.05.2018, me nr. protokoli 878/18; kërkesë për njohjen e statusit te personave paraplegjik dhe tetraplegjik i dt. 17.10.2017 ; vendimi 02.02.2018; shkrese e lëshuar nga Raiffeisen Bank e lëshuar me dt. 03.shtator 2018; fature e dt. 13.10.2017; fature e tatimit ne prone e lëshuar me dt. 17.10.2017; deklarate për bashkësinë familjare e lëshuar me dt. 12.10.2017; ekstrakt nga regjistri qendror i gjendjes civile me nr.serik E21....., i lëshuar me dt. 12.10.2020; fletëregjistrimi i dt. 25.01.2018; raport nga konsulta i dt. 12.10.2017; raport nga konsulta i dt. 13.10.2017; kopja e letërnjoftimit për Xh. R. e lëshuar me dt. 02.11.2012; raport nga konsulta i dt. 12.02.2018; udhëzim për konsultim i dt. 12.02.2018; ankese e dt. 13.11.2018; fletëza kompjuterike shëndetësore me nr. 004922; dosja e kërkesës për personat paraplegjik dhe tetraplegjik e dt. 17.10.2017; komisioni vlerësues për njohjen e statusit dhe te drejtave te personave paraplegjik dhe tetraplegjik – konstatimi dhe mendimi i komisionit mjekesore i dt. 29.01.2018.

Duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit kontestuese komfor Nenit 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA) – Ligji Nr. 03/L-202, gjykata pas administrimit të provave, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është **e bazuar**.

Me vendimin e të paditurës të datës 02.02.2018, gjykata vërejti se paditësit F. R., i është aprovuar kërkesa në kompensim për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik në kategorinë e dytë prej datës 10.10.2017, në shumën mujore prej 150 euro.

Në procedurën sipas ankesës e paditura me MPMS-së, Departamenti i Pensioneve, me vendimin e datës 23.03.2018, të goditur me padi, e ka refuzuar ankesa e ankueses, këtu paditësit F. R. në kompensim për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik me arsyetimin se paditësi nuk i plotëson kushtet ligjore në kategorinë e parë.

Nga vendimet kontestuar del se ato përmbajnë të meta të tilla për shkak të cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tyre. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 47 të këtij ligji është paraparë se akti administrativ, që në këtë rast nënkupton vendimet e goditura me padi, duhet të

përmbajë përveç tjerash edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike, bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruara nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilat bazohet akti etj. Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar. Në nenin 48 të po të njëjtit ligj, parashikohet se përveç rasteve ku ligji vet e parashikon dhënien e arsyeve, duhet të jepen domosdoshmërisht arsyet për të gjitha ato akte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në një mënyrë apo tjetër të drejtat dhe interesat ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara, ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar etj. Arsyetimet duhet të formulohen qartë dhe të përfshijnë shpjegimet e bazës ligjore dhe faktike të aktit.

Aktvendimi i kundërshtuar është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar. Në arsyetimin e vendimit është dhënë një formulim i përgjithshëm dhe abstrakt ku thuhet se *“ Pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, është vërtetuar se ankesa e juaj nuk është në harmoni me pikën 1 të nenit 8 dhe pikën 1 të nenit të Ligjit 05/L-06, prandaj ankesa refuzohet si e pa bazuar, derisa mbetet në fuqi vendimi mëparshëm.”*

Gjykata për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi, i'u referua Ligjit 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, përkatësisht nenit 1 me të cilin është përcaktuar që *“Me këtë ligj rregullohet statusi dhe të drejtat e personave, të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve të poshtme apo personave të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes të ekstremiteteve të sipërme dhe të poshtme të cilët marrin kompensim mujor”*, ndërsa neni 3 paragrafi 1, nën par. 1.1. , me të cilin është përcaktuar që *“Paraplegjikët – janë personat të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit të sistemit nervor qendror apo periferik kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve të poshtme”*, ndërsa me nenin 8 paragrafi 1 të po të njëjtit ligj është përcaktuar që *“Përfituesve të këtij ligji u njihet e drejta për një kujdestar personal, në bazë të vlerësimit nga komisioni vlerësues, me qëllim të ofrimit të kujdesit dhe shërbimeve të domosdoshme ditore, e të cilët kompensohen në shumën e njëjtë sikurse përfituesit e këtij ligji”*.

Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura në arsyetimin e vendimit të atakuar nuk ka dhënë arsye të mjaftueshme, nuk ka administruar asnjë provë nga e cila mund të vërtetohej fakti se paditësi nuk i plotëson kriteret e parapara ligjorë për të fituar statusin e personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, por vetëm ka dhënë një arsyetim të përgjithësuar duke u thirrur në nenin 8 paragrafi 1 të Ligjit numër 05/L-067 për Statusin e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik.

Më tutje, gjykata ka konstatuar se, komisioni vlerësues në rastin e vlerësimit të paditësit në shkallë të parë dhe të dytë ka qenë në përbërje në kundërshtim me nenin 17 par. 4. Ligjit numër 05/L-067 që përcakton se *“Përbërja dhe përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues caktohet nga Qeveria me akt nënligjor sipas propozimit të MSH-së dhe MPMS-së ndërsa një (1) anëtar caktohet nga shoqatat e licencuara që ofrojnë shërbime për*

*personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë në cilësinë e vëzhguesit si dhe Rregulloren Nr.07/2017 si akt nënligjorë, ku neni 4 i saj në mënyrë të çartë ka përcaktuar se: Komisioni Vlerësues, përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve dhe atë: 1.1. Një specialist i Mjekësisë së Punës, përkatësisht përfaqësues i MPMS-së, njëkohësisht dhe kryetar i komisionit sipas ligjit; 1.2. Një Neurolog; 1.3. Një Fiziatër 1.4. Një Kirurg i Përgjithshëm; 1.5. Një ekspert i fushës së punëve sociale i licencuar - niveli superior; 1.6. Një përfaqësues nga shoqatat e licencuara që ofrojnë shërbime për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë në cilësinë e vëzhguesit.*

Nga vlerësimi i Komisionit Vlerësues për Njohjen e Statusit dhe të Drejtave e Personave Paraplegjik dhe Teterpalegjik (KMPT), të datës 29.01.2018, gjykata gjeti se paditësi gjatë ekzaminimit është vlerësuar nga ky komisioni i cili ka qenë në përbërje të tre(3) anëtarëve.

Meqë paditësi nga organi administrativ është vlerësuar nga tre (3) anëtarë, pra nga një Komision Mjekësorë në përbërje jo të plotë dhe nga ekspert jo përkatës të përcaktuar sipas aktit nënligjor të lartë cituar, andaj për këto arsye, kjo gjykatë e obligon organin e paditur që në ri-procedurë edhe një herë të vlerësojë paditësin në përbërje të plotë të Komisionit Vlerësues të ekspertëve të fushave të përcaktuara në përputhje me Ligjin dhe Rregulloren e lart cituar për të pasur një vlerësim profesional dhe në pajtim me etikën mjekësore, si dhe për të siguruar garantimin në trajtim dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të kësaj kategorie të personave në nevoja për shërbime.

Andaj, Gjykata si rregull, konfliktin administrativ e vendosë në bazë të gjendjes faktike, të vërtetuar nga ana e organeve administrative, ndërsa nga aktvendimi i goditur në padi nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike. Andaj, çështja nuk është vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë në organin e shkallës së dytë, me aktvendimin i të cilit është refuzuar ankesa e paditësit.

Të metat e cekura më lartë janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së aktvendimit të kundërshtuar dhe në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur që në afat prej 30 ditësh, në ri procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi t'i mënjanoj të metat e cekura, të merr aktvendim të drejtë të bazuar në ligj.

Duke u bazuar në të dhënat e lart cekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**DEPARTAMENTI PËR ÇËSHTJE ADMINISTRATIVE**  
**A.nr.1019/18, datë 12.01.2021**

Zyrtare Ligjore  
Besë Sylaj

G j y k t a r e  
Luljeta Maxhuni

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.